



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, _____.____.2022

VENDIM

Nr. 19, datë 30.05.2022

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT MBI REALIZIMIN E BUXHETIT
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR TREMUJORIN E PARË TË MBYLLUR NË 31 MARS 2022**

Në bazë dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “l”, të nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, të nenit 62 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 20, pika 4 të Rregullores nr. 34, datë 27.11.2020 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 6, pika 2, shkronja “d”, të nenit 8, pika 2, shkronja “m” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin mbi realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tremujorin e parë të mbyllur në 31 mars 2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj
Sekretare

Donald Duraj
Kryetar

